

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI****VENDIM****Nr. 10, Datë 29.01.2024****MBI****KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” SH.P.K. PËR  
HEQJEN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, gërma “dh” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, gërma “dh”, 7 paragrafi 2 dhe 9, gërma “d” të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 18, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikës 9.1, gërma “a” të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 98, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.01.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 208 prot., datë 22.01.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k. për heqjen e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe heqjen e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 277, seria FK15/F20, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 38, datë 18.03.2015, rinovuar me vendimin nr. 46, datë 18.03.2020, për një afat 5-vjeçar (deri më 18.03.2025).
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2564 prot., datë 26.12.2023, nga shoqëria “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., kërkohet fillimi i procedurave për heqjen e kësaj licence, për arsye se kjo shoqëri ka nisur procedurën e likuidimit të saj.
- Sa konstatuar nga ekstrakti historik i shoqërisë në QKB, shoqëria ka statusin “Në likuidim e sipër” dhe në datën 17.10.2023 është publikuar vendimi i Asamblesë së Ortakëve të saj për fillimin e procedurave të likuidimit dhe caktimin e likuidatorit përkatës.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 196, pika 1, dhe nenit 197, pika 1, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, likuidatori ka tagrin për të kryer veprimet e nevojshme për të mbyllur veprimtarinë e shoqërisë.
- Në nenin 42, pika 1, gërma “dh” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenin 5, gërma “dh” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 58, datë 18.04.2017, si dhe pikën 9.1, gërma “a” të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 98, datë 17.06.2016, përcaktohet se: *ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit.*
- Në zbatim të neneve 7, paragrafi 2, gërmat “dh” dhe “e” dhe 9, gërma “d” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror” janë plotësuar kërkesat e Rregullores që ERE të procedojë me heqjen e licencës së shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k.
- Duke qenë se ndodhemi në kushtet kur kërkesa për heqjen e licencës vjen nga vetë i licencuari (likuiduesi) dhe janë shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s, vlerësohet të procedohet menjëherë me miratimin e kësaj kërkesë dhe heqjen e licencës.
- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, kjo licencë e humbet fuqinë juridike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., për heqjen e licencës nr. 277, seria FK15/F20, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 38, datë 18.03.2015, rinovuar me vendimin nr. 46, datë 18.03.2020.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar e humbet fuqinë juridike.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. dhe shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike “ALPEX” sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**